



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401129/3

Tiranë ____/____/2014

Lënda: *Rekomandojmë, që brenda kriterëve mjekësorë, të krijohet mundësia e rishikimit të dokumentacionit të shtetases M. Gj për përfitimin e grupit të invaliditetit, si një rast specifik në kushtet e ndodhura për shkak të gjendjes së saj shëndetësore*

Drejtuar: **Kryetarit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë Për Punë (KMCAPI)**

FIER

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur një kërkesë shtetasi M.Gj, me anë të së cilës kërkon ndërhyrjen tonë pranë KMCAPI-t Fier për dhënien e mundësisë për vazhdimin e grupit të invaliditetit të vajzës së tij të sëmurë, shtetases M.Gj

Sipas shpjegimeve të parashtruara, vajza e tij prej 36 vitesh është e sëmurë me veshkat. Që në vitin 1995 ka përfituar grup të dytë të invaliditetit. Prej disa vitesh ndodhet në shtetin Grek për t'u kuruar dhe çdo javë duhet të paraqitet tek mjeku specialist.

Duke qenë se nga ana e komisionit tuaj ishte deklaruar në vijimësi me grup të dytë invaliditeti për periudhën 01.04.2013-31.03.2014, në muajin Mars 2014, ankuesi ka dorëzuar dokumentacionin përkatës të vajzës së tij, me qëllim për të vazhduar grupin e invaliditetit të përfituar prej vitesh, por ka marrë përgjigje se vajza e tij duhet të jetë prezent në komision.

Nga dokumentacioni bashkangjitur, konstatojmë se, sipas vendimit nr.161/2013 të Gjykatës së Shkallës së Parë në Patra, Greqi, me objekt; pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.6634/1/2126-a/17.05.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Greqisë Lindore, në pjesën arsyetuese të tij, theksohet fakti se *shtetasja M.Gj iu nënshtrua transplantit të veshkës më datë*

10.05.2011 dhe ndiqet nga klinikat e jashtme çdo 4 javë dhe kryen terapi si dhe ky kontroll i saj është i domosdoshëm për mbijetimin e saj dhe të transplantit, ndërkohë që duhet të banojë afër një qendre transplantimi për trajtimin e çdo rreziku të mundshëm për jetën e saj si dhe për funksionimin e transplantit.

Për arsye se nga ky vërtetim rezulton se ekziston rrezik serioz për jetën e saj dhe se ka nevojë për kontroll të vazhdueshëm në qendër transplantimi dhe si rezultat gjykohet i detyrueshëm qëndrimi i saj në shtetin tonë për të shmangur çdo rrezik të mundshëm.

Duke qenë në këto kushte, e sëmura nuk mund të paraqitet pranë atij komisioni për të përfituar grup invaliditeti, pasi kjo do t'i krijonte mjaft probleme gjëndjes shëndetësore të saj.

Sa më lart, duke ditur gjëndjen shëndetësore të shtetases Mirela Gjeli, e cila nuk del për herë të parë në komision, por e ka përfituar prej vitesh grupin e invaliditetit nga komisioni juaj mjekësor dhe në pamundësi objektive për t'u paraqitur personalisht,

R E K O M A N D O J M Ë:

Rishikimin e dokumentacionit të shtetases M.Gj për përfitimin e grupit të invaliditetit, si nje rast specifik në kushtet e ndodhura për shkak të gjendjes së saj shëndetësore.

Lutemi ta shqyrtoni me preçedence dhe të na vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.

Bashkangjitur ju dërgojmë kopje të:

- Vendimit nr.161/2013 të Gjykatës së Shkallës së Parë në Patra, Greqi
- Të vërtetimit nga Komisioni Mjekësor i Punës datë 26.04.1995.
- Vërtetimin me nr.1522 datë 24.02.2014 të Spitalit të Përgjithshëm Universitar në Patra.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI